



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

Relacion

“Raport për Vlerësimin e Parashikimit Afatmesëm 2020-2022 të të Ardhurave”

Të nderuar këshilltarë!

Projekt vendimi - “Raport për Vlerësimin e Parashikimit Afatmesëm të të Ardhurave” ju propozohet për miratim keshillit bashkiak mbështetur në:

- Ligjin nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, neni 34 pika 1- germa a,b,c pika 2 - germa a,b,c.
- V.K.B nr. 141 , datë 07.12.2018 “Për miratimin e Kalendarit për Programin Buxhetor Afatmesëm 2020-2022 dhe Buxhetin vjetor 2020.”
- Ministri i Financave dhe Ekonomisë, ka nxjere udhëzim nr. 7 date 27.02.2019 “ Për përgatitjen e PBA vendor 2020-2022

Ky material hartohet per here te dyte për Bashkinë. Kjo në zbatim të ligjit nr.68/2017 ,si detyrim ligjor, Kryetari i Njesisë së Vetëqeverisjes Vendore paraqet për shqyrtim dhe miratim në këshill Raport për Vlerësimin e Parashikimit Afatmesëm të të Ardhurave .

Kuadri Makroekonomik e Fiskal për periudhën 2020-2022 i miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 4 datë 09.01.2019, përcakton kontekstin ekonomik për Programin Buxhetor Afatmesëm 2020-2022. Kuadri pasqyron parashikime të treguesve ekonomik dhe financiar të buxhetit të qeverisjes vendore për tre vitet e ardhshme.

Në kuadër të zbatimit të këtij ligji, Drejtoritë që krijojnë të Ardhura në Bashkinë Berat kanë sjellë këtë material përmbledhës.

Në zbatim të nenit 34 pika 1- germa a, b , c të Ligjit 68/2017 ,ju paraqesim në tablën e mëposhtëme, vlerësimin dhe parashikimin e të ardhurave për dy vitet para vitit buxhetor,vitin buxhetor dhe tre vitet e ardhshme buxhetore. Ju theksojmë se kjo tabelë është pjesë edhe Buxhetit të Vitit 2019 dhe PBA Përfundimtare 2019-2021 miratuar nga Këshilli Bashkiak.Eshtë shtuar vetëm parashikimi për vitin 2022.



REPUBLICA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

Nr	Emertimi/Muaji	Fakti 2017	Fakti 2018	Plani 2019	Plani 2020	Plani 2021	Plani 2022
I	Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin per biznesin e vogel ,Te ardhura nga tatimi mbi te ardhurat personale.	4,014	2,303	3,000	3,090	3,183	3,278
II	Taksat vendore	229,522	169,475	219,881	226,478	233,272	240,270
1	Takse table	7,973	4,538	3,312	3,411	3,514	3,619
•	Tabelë për qëllime identifikimi	5,830	3,374	2,188	2,254	2,321	2,391
•	Tabelë për qëllime reklamimi	2,143	1,164	1,124	1,158	1,192	1,228
2	Te ardhura nga zënia e hapsirave publike	13,450	13,247	14,500	14,935	15,383	15,845
3	Takse ndikimi ne infrastrukture nga ndertimet e reja	74,893	51,382	58,600	60,358	62,169	64,034
3	Takse fjetje ne hotel	4,651	4,690	4,781	4,925	5,072	5,225
4	Takse mbi token bujqesore	29,047	15,619	28,213	29,059	29,931	30,829
5	Takse e mjeteve te perdorura	19,178	26,572	27,843	28,678	29,539	30,425
6	Takse e kalimit te se drejtes se pronesisë	2,478	1,904	3,297	3,396	3,498	3,603
7	Takse mbi ndertesat	61,758	44,360	61,126	62,960	64,849	66,794
•	Biznes			23,923	24,641	25,380	26,141
•	Familje			37,203	38,319	39,469	40,653
8	Takse Trualli	6,789	7,150	9,799	10,093	10,396	10,708
9	Te tjera taksa lokale	9,305	13				
10	Takse e perkohshme Ambienti			700	721	743	765
11	Takse e rentes minerare + Tap Gazesjelles			3,200	3,296	3,395	3,497
12	Taksa mbi te ardhurat personale			4,510	4,645	4,785	4,928
III	Tarifat vendore	113,088	116,144	122,590	126,268	130,056	133,958
1	Tarife e pastrimit	70,390	65,605	75,032	77,283	79,601	81,989
•	Biznes			47,152	48,567	50,024	51,524
•	Familje			26,455	27,249	28,066	28,908
•	Institucione			1,425	1,468	1,512	1,557
2	Tarife e ndricimit publik	24,154	25,018	28,271	29,119	29,993	30,892
•	Biznes			10,188	10,494	10,808	11,133
•	Familje			17,911	18,448	19,002	19,572
•	Institucione			172	177	182	188
3	Tarife gjelberimi publik	13,033	12,738	14,746	15,188	15,644	16,113
•	Biznes			6,758	6,961	7,170	7,385
•	Familje			7,902	8,139	8,383	8,635
•	Institucione			86	89	91	94
4	Tarife regjistrim veprimtarie biznesi	2,197	1,753	2,129	2,193	2,259	2,326
5	Tarifa urbanistike	313	2,237		0	0	0
6	Tarifa te sherbimit administrativ	57	204	932	960	989	1,019
7	Tarife per license/certifikate ne fushen e	1,314	1,635	280	288	297	306
8	Tarifa per zenien e sallave dhe celje kartelexuesi						
9	Tarifa te sherbimit te varrimit						
10	Tarife per lende drusore	166	2,092				
11	Tarife uji i pijshem(Ujitje)	3					
	Tarife therie	298	1,060	1,200	1,236	1,273	1,311
12	Te tjera tarifa	1,163	3,802				
IV	Tarifa te Drejtorise Ekonomike te Arsimit	11,895	10,632	31,447	32,390	33,362	34,363
1	Te ardhura nga konviktet	412	341	770	793	817	841
2	Te ardhura nga cerdhet	3,861	485	7,300	7,519	7,745	7,977
3	Te ardhura nga kopshtet	7,622	9,806	17,811	18,345	18,896	19,463
4	Tarifa te kontrollit te zhvillimit te territorit			2,500	2,575	2,652	2,732
5	Tarife per pyjet dhe kullotat			1,000	1,030	1,061	1,093
6	Tarife sherbimi shtese nga zjarri			1,613	1,661	1,711	1,763
7	Te tjera tarifa drejtoria e bujqesise			453	467	481	495
V	Te ardhura te tjera	13,378	35,692	122,048	125,709	129,480	133,365
1	Te ardhura nga parkimi	2,721	2,952	3,025	3,116	3,209	3,305
2	Te ardhura nga qerate	8,761	29,608	50,976	52,505	54,080	55,703
3	Te ardhura nga gjobat, k. vonesa etj..	1,896	3,132	28,463	29,317	30,196	31,102
4	Te tjera te ardhura nga pronesia						
5	Te ardhura nga biletat						
6	Te tjera debitore dhe gjyqe			35,000	36,050	37,132	38,245
7	Bibloteka			283	291	300	309
8	Banesat Sociale + Enti			4,301	4,430	4,563	4,700
VI	Te ardhura nga legalizimet				0	0	0
	TOTALI	371,897	334,246	498,966	513,935	529,353	545,234



BASHKIA BERAT

Ky planifikim është mbështetur në bazë të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.57 date 28.12.2015 "Për miratimin e Sistemit të Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Berat" i ndryshuar, si të gjitha vendimet që kanë hyrë për miratim në Këshill Bashkiak "Për disa shtesa dhe Ndryshime të këtij vendimi", dhe në legjislacionet përkatëse. Baza e përllogaritjeve janë të gjitha të dhënat nga secila Drejtori të cilat krijojnë të ardhura për Bashkinë, referuar realizimit 12 mujor, situatën faktike 12 mujore, trendit të dy viteve parardhëse, e bazuar kjo në legjislacionet përkatëse që i referohet cdo Drejtori, Njësi Shpenzuese e Bashkisë, apo Njësi Administrative.

Per vitet 2020 - 2022 mendohet të kenë rritje, përkatësisht bërë një parashikim i përafërt, me një rritje të përgjithshme 3%, duke qënë në kuadrin e planifikimit dhe në trendin e rritjes mesatare të PBB, bazuar në Vkm nr. 47, datë 25.01.2017. Këto parashikime mbështeten në llogaritjet e përgjithshme që janë të lidhura ngushtë me masat që pritet të ndërmerren nga administrata tatimore në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse të Bashkisë, por dhe jashtë saj, për realizimin e parashikimeve të pretenduara të të ardhurave. Parashikimi i të ardhurave për këtë periudhë parashikon rritjen e nivelit të të ardhurave nga taksat e tarifave vendore dhe të ardhura të tjera, duke forcuar kapacitetet administruese dhe duke rritur numrin e taksapaguesve, por jo me ndryshime në nivelet e taksave apo tarifave.

Risqet që mund të cojnë në mosrealizim të këtyre të ardhurave, dhe masat për përbalimin e tyre, të paraqitura nga disa Drejtori që krijojnë të ardhurat më të mëdha për Bashkinë Berat, janë paraqitur si më poshtë:

Drejtoria e Taksave dhe Tarifave.

Ndryshimet në Legjislacionet përkatëse përsa përket taksave dhe tarifave të biznesit dhe familjeve.

Mbyllja e bizneseve.

Paksim i numrit të bizneseve të reja.

Paksim i numrit të familjeve të reja.

Mosfunksionim i strukturave të kontrollit.

Personel i reduktuar në strukturën e kontrollit dhe trajnime përkatëse.

Mostrajnim i stafit, në lidhje me zbatim të legjislacioneve dhe procedurave përkatëse.

Mosbashkërendim të punëve mes institucioneve, drejtorive dhe Drejtorisë së Taksave.

Database me të dhëna që duhen rifreskuar në vazhdimësi.

Risqet mund të jenë të shumta por masat që do merren janë :

Manaxhim sa më i mirë dhe efektiv i strukturave kundrejt krimjit të databeve të sakta.

Funksionim sa më eficient dhe efektiv i strukturave të kontrollit.

Trajnime të vazhdueshme të stafit në bashkëpunim me Infosoft dhe Usaid për pjesën e sistemit të taksave.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

Drejtoria e Arsimit, Bashkia Berat.

Për vitin 2019 numri i fëmijëve është parashikuar më i lartë krahasuar me dy vitet e mëparshme për arsye të hapjes të dy kopeshteve të reja me ushqim dhe të një cerdheje. Risqet që mund të pengojnë që të realizohen këto objektiva të sigurimit të të ardhurave janë:- Ulja e numrit të fëmijëve për arsye të planifikimit familjar, mosfrekuentimi si pasojë e virozave të stinës, ulja e numrit të nxënësve që frekuentojnë shkollat e mesme profesionale.

Këto risqe ndikohen nga shumë faktorë ,por gjithsesi ajo cka ofron Bashkia,krijimi i kushteve akomoduese të fëmijëve në cerdhe,kopshte,shkolla,sipas standarteve të kërkuara dhe duke respektuar detyrat dhe funksionet që ajo ka.

Drejtoria e Manaxhimit të Pronave dhe Strehimit.

Mos funksionim i Kontrolleve si dhe mos ndërgjegjësim i personave që banojnë në banesat sociale.

Mungesa e fondeve nga qeveria për arritjen e realizimit të projektit të kredisë së zbutur.Mungesa e truallit të lirë për ndërtimin e banesave me kosto të ulët nga Enti Kombëtar i Banesave .

Paaftësia paguese e zotëruesve të banesave,pronave,të mara me qera dhe në shrytëzim nga qytetarë dhe biznese.

Ndryshimet në legjislacionet përkatëse.

Ulja e numrit të njesive,pronave, të dhëna me qira.

Ndryshimet ligjore dhe mosndjekja e procedurave ligjore në kohën e duhur.

Drejtoria e Bujqsisë ,Administrimit të Pyjeve,Ujërave dhe Shërbimit Veterinar.

Drejtoria e Bujqësisë, Administrimit të Pyjeve, Ujërave dhe Shërbimit Veterinar për shitjen e materialit drusor ka parashikuar risk uljen e kërkesës së konsumatorit ndërsa për vjeljen e tarifës së ujitjes parashikon pamundësinë e vjeljes 100% të tarifës nga refuzimet e fermerëve të ndryshëm.

Ndryshimet ligjore që mund të ndodhin.

Mos kualifikim stafi e mungesë trajnimi.

Drejtoria e Planifikim dhe Zhvillim Territorit.

Ka vlersuar për tu përmedur këto risqe në këtë material.

Mos hartimi i planeve të detajuara vendore në kohën e duhur.

Ndryshimet në legjislacionet përkatëse.

Mostrajnim i stafit.

Lëvizjet e popullsisë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

Ritmi ë ndryshimit të numrit të familjeve të reja.

Por gjithsesi vlen të theksohet që në këtë dy vjekar të fundit, ndryshimet ligjore në VKM nr.408 datë 31.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit “ , ka sjellë që rritje të ndjeshme të nivelit të ardhurave nga lejet e ndërtimit dhe tarifave të ndryshme të urbanistikës.

Pavarsisht se RISKU, si nocion ka një diapazon të gjerë për shpjegim dhe zbatim të punës së vazhdueshme për uljen e nivelit të tij, mund të përmendim që: Eshtë detyrë e çdo Drejtuesi, dhe e stafit të tyre për uljen e riskut ,sidmos të atyre risqeve që nuk ndikohen nga faktorë të jashtëm dhe që manaxhohen direkt nga Drejtoria përkatëse.

Duke ju ftuar që të votoni projekt-vendimin e paraqitur, ju falenderoj për bashkëpunimin tuaj!

Drejtore i Taksave dhe Tarifave
Rinald Frashëri

Drejtore i Arsmit
Teuta Mucogllava

Drejtore Manaxhimit të Pronave dhe Strehimit.
Hajrie Mbrati

Drejtore i Bujqsisë ,Administrimit të Pyjeve, Ujërave dhe Shërbimit Veterinar
Rajmond Abazi

Drejtore i Planifikim dhe Zhvillim Territorit
Sllavi DHRAMI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

PROJEKTVENDIM

RAPORT PËR VLERËSIMIN E PARASHIKIMIT AFATMESËM 2020-2022 TË TË
ARDHURAVE

Kryetari i Bashkisë pasi u njoh "Raport për Vlerësimin e Parashikimit Afatmesëm 2020-2022 të të Ardhurave", mbështetur në ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 8/2, neni 9, neni 64 gërma "c"; ligjin 68 /2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 34; Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.7, datë 27.02.2019 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm vendor 2020-2022" dhe VKB nr. 141, datë 07.12.2018 "Për miratimin e Kalendarit për Programin Buxhetor Afatmesëm 2020-2022 dhe Buxhetin vjetor 2020"

PROPOZON:

1. Miratimin e Raportit për Vlerësimin e Parashikimit Afatmesëm 2020-2022 të të Ardhurave, bashkëlidhur këtij projektvendimi.
2. Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarohen të gjitha drejtoritë e bashkisë dhe njësitë vartëse.

KRYETARI I BASHKISË
Petrit SINAJ

Ky projektvendim u pa dhe ka bazueshmëri ligjore.

JURISTE
BASHKIAK
Nertila KADËNA

SEKRETARE E KESHILLIT

Ledina GJOROVENI